



Drejtoria Komunale e Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje
Department of Education

Nr.Protkolli:04/747

03.02.2023

Rahovec

Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032,të datës 29.08.2011, nenit 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5,paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it. Udhëzimit Administrativ te MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativ për Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

Konkurs

Për plotësimin e **1 pozite** të lirë të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2022/2023, në Institucionet edukativo-arsimore.

Mësimdhënës/e për Lëndën Histori dhe Edukatë Qytetare, 10 orë mësimore për Lëndën e Historisë dhe 6 orë mësimore për Lëndën e Edukatës Qytetare.

Kushtet për konkurrim:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional sipas U.A.05.2021, Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm), ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar,
- Kopjet e çertifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime.

Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret në DKA/shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>

Lista Pritëse:

Kandidatët të cilët grumbullojnë më shumë se 59 pikë, hynë në Listën pritëse si kandidat fitues, dhe nëse paraqitet nevoja për ndonjë pozitë të lirë- **Mësimdhënës/e për Lëndën e Historisë dhe Edukatë Qytetare,** kanë të drejtë të punësohen.

Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës .

Aplikimi në konkurs:

Afati i aplikimit fillon prej datës: **06.03.2023** dhe zgjat **8 ditë** kalendarike dhe atë deri me datë:**14.03.2023**, deri ne ora: **16:00**.



Avni Morina, Drejtor